

RREGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	01.03.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë akt martese	01.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se te gjitha certifikatat që datojnë akte (lindje, martese, vdekje, etj) para vitit 2010, nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata procedohet si më poshtë: Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha bashkitë e komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranëprefekturave të qarqeverespektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
2	02.03.2023	Kërkesë për informacion për plan rievimi	02.03.2023	Pershendetje! Përpos dokumentin origjinal qe ju ka kerkuar zyra e ASHK-së, plan rievimi nuk aplikohet në e-albania por bëhet pranë një zyre Topografike referuar VKM në fjalë. Dokumentat origjinal së bashku me plan rievimin depozitohen me anë të aplikimit "AKT Verifikimi, AV0" dhe gjithashtu edhe në rrugë postare së bashku me mandat pagesën me vlerë zero të gjeneruar nga sistemi. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Jemi në shërbim për t`Ju asistuar në kohë reale.	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

3	03.03.2023	Kërkesë për informacion për lëshim vërtetimesh	03.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju mund të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin në linkun e mëposhtëm: Aplikim për lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv për të gjithë territorin) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13978 Ky shërbim u mundëson qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për t'u pajisur me një vërtetim që është pronar ose jo pronar i ndonjë pasurie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pas dërgimit të aplikimit drejt ASHK-së, ai do të procesohet nga specialisti i ASHK-së dhe në varësi të informacionit kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike tek “Dokumentet e mia” në profilin e qytetarit në e-Albania. Për çdo pyetje paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, në mënyrë që t`Ju asistojmë për veprime të mëtejshme.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
4	03.03.2023	Kërkesë për informacion për pajisje e subjektit me nënshkrim elektronik.	03.03.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Kerkoj të pajis një Subjekt me Nënshkrimin Elektronik.FALEMINDERIT.	E deleguar	Nuk ka
5	03.03.2023	Kërkesë e paqartë për informacion	03.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa Juaj është e paqartë por gjithsesi për të dërguar kërkesën për pension pleqërie, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundruet i nëndetëseve apo suplementar për akademik, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156 Për çdo pyetje dhe paqartësi mund të na kontaktoni përsëri! Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
6	03.03.2023	Kërkesë për informacion për	06.03.2023	Përshëndetje! Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk ka dokument tjetër që mund të përdoret për të udhëtuar nga Shqipëria përveç	E plotë	Nuk ka

		përfitimin e pasaportës biometrike		passaportës. Megjithatë, ju mund të aplikoni për përftimin e një passaporte biometrike me proces të përshpejtuar, ku afati për nxjerrjen e passaportës është brenda 3 ditësh nga dita e aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, në mënyrë që t`Ju asistojmë për veprime të mëtejshme.Faleminderit!		
7	03.03.2023	Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi	06.03.2023	Përshëndetje! Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, për të bërë ndryshimin e vendbanimit duhet të shkoni pranë Gjendjes Civile ku ju dëshironi të keni vendbanimin e ri, ose mund të aplikoni nëpërmjet portalit eAlbania për shërbimin me emër “Aplikim për ndryshim/saktësim vendbanimi”. Dokumentacioni i nevojshëm për të kryer shpërnguljen është si më poshtë vijon: Fotokopje e letërnjoftimit (karta e identitetit); Kontratën apo çdo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës, ose; Dokumentin e pronësisë së banesës ose kontratë qiramarrje/ huadhënie/ përdorim apo banim. Ndryshimi i vendbanimit bëhet menjëherë, ju do të pajiseni me certifikatë lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në bashki/Njësi Administrative nën juridiksionin e së cilës është vendbanimi i ri.Për cdo pyetje paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, në mënyrë që t`Ju asistojmë për veprime të mëtejshme. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
8	03.03.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë martesore	06.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se te gjitha certifikatat që datojnë akte (lindje, martese, vdekje, etj) para vitit 2010, nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata procedohet si më poshtë: Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha bashkitë e komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
9	03.03.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martese me shtetas të huaj	06.03.2023	Përshëndetje! Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës është shpallja e martesës. Shpallja e martesës pa qenë i/e pranishëm kryhet me prokurë të posacme . Procedura për të bërë shpalljen e martesës është si më poshtë vijon:Në rastin e lidhjes së martesës me	E plotë	Nuk ka

				një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar):Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;Fotokopje e dokumentit të identifikimit.Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar.Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: Certifikatë lindje; Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
10	05.03.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë pronësie	06.03.2023	Përshëndetje! Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përshëndetje, po ju vendos në dispozicion këtë kërkesë me shkrim për ndarjen e pasurisë së paluajtshme (truall, parcelë ndërtimore). Dokumentat	E deleguar	Nuk ka

				për pasurinë 17/32-ND, zk. 8604, si dhe fatura e pagesës së parcelës ndërtimore (Ref.pasurie 18704) bashkangjitur kërkesës nr. 24325, me datë aplikimi 23.07.2021. Në pritje të lëshimit të certifikatës së pronësisë së truallit! (P. S: Nëse është e nevojshme të përditësohet ose korrigjohet harta kadastrale për këtë zonë, ku trualli dhe ndërtesa e banesës sime bien në të njëjtën parcelë ndërtimore, të vihet për verifikime në terren).		
11	03.03.2023	Kërkesë për informacion për dokumentacion për fillimin e punës	06.03.2023	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, dokumentat që dorezohen tek punëdhënësi gjatë procesit të fillimit të punës dorëzohen në momentin kur nënshkruhet kontrata e punës ndërmjet palëve. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
12	06.03.2023	Kërkesë për informacion për maturën shtetërore	06.03.2023	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju duhet të kontaktoni me suportmatura@e-albania.al për të adresuar problematikën tuaj. Megjithatë, Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
13	06.06.2023	Kërkesë e paplotë për informacion	06.06.2023	Pershendetje! Në vijim të emailit të mëposhtëm lutem kërkojmë një shpjegim më të detajuar rreth kërkesës Tuaj për informacion,pasi kërkesa juaj është e paplotë. Pra nëse kërkonit të bëni shpalljen e martesës apo kerkoni të regjistroni aktin e martesës .Për çdo pyetje paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, në mënyrë që t`Ju asistojmë për veprime të mëtejshme.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
14	06.06.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë trangu familjar	06.06.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trngut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë:Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë.Për rrethinat e Tiranës, merren tek Prefektura Tiranë.Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqiperisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

15	06.03.2023	Kërkesë për informacion për hyrje në e-albania	06.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
16	06.03.2023	Kërkesë e përgjithshme për informacion	06.03.2023	According to your email, For any question or uncertainty, contact us on the free number 0800 0118, from Monday to Friday, from 08:00 to 19:00 or our chat online adisa.gov.al . Thank you!	E plotë	Nuk ka
17	06.03.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë mes dy shtetasve shqiptarë	06.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; fotokopje e dokumentit të identifikimit. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalën informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

18	07.03.2023	Kërkesë për informacion për shpallje martese	07.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije së pas shpalljes së martesës, procedura vijon më poshtë vijon : Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Nuk keni specifikuar nëse celebrimin do e bëni në Shqiperi apo jashtë vendi . Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalën informativë pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte në fashën orare 08.00 – 19.00.	E plotë	Nuk ka
19	06.03.2023	Kërkesë për informacion për lëshim të kartelës së pasurisë	07.03.2023	Përshëndetje! Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si mund të kërkoj kartelën e e pasurisë së babait i cili nuk jeton më,në Shkodër. Më është kërkuar të bëj kalimin e pasurisë nga ai te trashëgimtarët, une motra dhe mami, për arsye të dëmshpërblimit nga Bashkia Shkodër. Më ka ardhur me postë njoftimi i Bashkisë Shkodër ku figuron babai im.	E deleguar	Nuk ka
20	06.03.2023	Kërkesë për informacion për përfitim shtetësie shqiptare	07.03.2023	Hello sir, According to your question, here are the criteria to apply for Albanian citizenship:A foreign citizen has the right to request Albanian citizenship by naturalization when the following conditions are met: - To have reached the age of 18 years. The calculation is made on the day of making the request; - To have resided legally in the territory of the Republic of Albania, continuously, for no less than 5 years; - Have a home and have sufficient income; - Not to have ever been convicted (in the Republic of Albania or in any other country) for criminal offenses, for which the law provides punishments of not less than 3 years of imprisonment. Exceptions to this rule are made in cases where it is estimated that the sentence was given for political motives; - To have at least basic knowledge of the	E plotë	Nuk ka

				Albanian language; - The granting of Albanian citizenship should not affect the security and defense of the Republic of Albania. For any further questions you can contact us through our online chatbox at the link https://www.adisa.gov.al/ or you can call us for free on 0800 0118, Thank you.		
21	07.03.2023	Kërkesë për informacion për deklarim të humbjes së dokumenteve të ndryshme	07.03.2023	Përshëndetje! Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të denoncuar dokumentet e humbura, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania sherbimin: Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922 . Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular. Pas përgatitjes së vërtetimit të humbjes, do të njoftoheni me e-mail dhe te seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania brenda 3(tre) diteve. Printoni vërtetimin, blini kuponin pranë sporteleve të Postës Shqiptare, rezervoni tek Aleat në adresën rezervo.aleat.al, dhe paraqituni pranë pikës Aleat në orën dhe datën e caktuar. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
22	07.03.2023	Kërkesë për informacion për njehesimin e diplomës së huaj	07.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për rastet kur aplikanti kryen pagesën, mund ta depozitoni shumën nëpërmjet bankës ose zyrave të postës shqiptare. Megjithatë, për informacion më të plotë lidhur me procesin e njehsimit të diplomës, klikoni në linkun sa më poshtë për t'u informuar më mirë: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 Gjithashtu, Për çdo pyetje apo paqartësi mund të na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte në fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
23	07.03.2023	Kërkesë për informacion për aplikim për pajisje me NIPT fermeri	07.03.2023	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar NIPT fermeri, ju duhet të aplikoni për shërbimin Kërkesë për Rregjistrimin e një Subjekti Tatimpagues në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13938 .	E plotë	Nuk ka

				Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
24	07.03.2023	Kërkesë për informacion për aplikim vërtetimi ndërtimi informal	07.03.2023	Përhëndetje. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përhëndetje, si jeni? Kam bërë një Aplikim për vërtetim të ndërtimit informal në e-albania , me datë 15.02.2023 me nr gjurmimi ALUIZNI-2023-6752117-SW. Ku mund të marr një përgjigje të aplikimit. Faleminderit paraprakisht!	E deleguar	Nuk ka
25	07.03.2023	Kërkesë e paplotë për informacion	08.03.2023	Përhëndetje, Kërkesa juaj është e paplotë për informacion. Jeni të lutur të na dërgoni një kërkesë më të plotë, si për shembull për çfarë keni aplikuar dhe çfarë lloj aplikimi keni kryer. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
26	08.03.2023	Kërkesë për informacion për rishqyrtim pensioni	09.03.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se ju mund të bëni një kërkesë për rishqyrtim pensioni në portalin e-albania. Hapat e procedures: - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania - Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për rishqyrtim përfitimi (pension)" - Klikoni butonin "Përdor" - Plotësoni formularin përkatës për këtë kërkesë - Numri juaj i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që ju hyni në portal me kredencialet tuaja. - Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. - Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave. - Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë. - Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër ose mund ta dërgoni menjëherë për procesim në serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. - Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatës. Ju lutem mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj. Bashkëlidhur do të gjeni linkun për të kryer këtë kërkesë: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=2304 Për cdo	E plotë	Nuk ka

				pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
27	09.03.2023	Kërkesë për informacion për aplikim për Licensë Formimi Profesional	10.03.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të kryer Aplikimin për Licensë për Formim Profesional për OJF dokumentat që duhet të dorëzohen nga aplikanti janë: 1. Akti i themelimit të shoqërisë 2. Statuti i shoqërisë Sakaq, dokumenti "Ekstrakt historik i lëshuar nga gjykata" që më parë ishte detyrim të dorëzohej në zyrat e shtetit nga vetë aplikanti, <i>tani është detyrë e nëpunësit të administratës ta sigurojë këtë dokument për qytetarin. Pra ju nuk duhet të dorëzoni këtë dokument, por vetëm dy të mësipërmet.</i> Hapat e procedures - Identifikohuni si biznes në portalin e-albania - Zgjidhni shërbimin Liçensim për “Aplikim për licensë për formim profesional” - Klikoni butonin " Përdor" - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi adresën e biznesit dhe ngarkoni dokumentet e nevojshme të kriterëve të licencës. - Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit. - Merrni numrin e çështjes në përgjigje të dërgimit të aplikimit, me të cilën mund të gjurmoni më pas çështjen e hapur duke përdorur shërbimin ”Gjurmimi i çështjeve nga Qendra Kombëtare e Biznesit (licenca)”. - Dërgoni me postë ose dorëzoni në sportelin e QKB-së versionin origjinal vetëm për dokumentet e skanuara gjatë aplikimit online. - Sportelisti verifikon dokumentet e aplikimit dhe nëse ato janë të gjitha të nënshkruara elektronikisht, e konfirmon çështjen duke e kaluar te regjistruesi. Nëse një pjesë e dokumenteve janë të panënshkruara elektronikisht (pra, të skanuara nga origjinali), atëherë sportelisti e le pezull çështjen deri në mbërritjen e dokumenteve origjinale. - Pasi dokumentet origjinale mbërrijnë në QKB, sportelisti verifikon që ato janë të njëjta me versionin e skanuar të dërguar gjatë aplikimit online. Më pas konfirmon krijimin e çështjes (sistemi i brendshëm i QKB-së gjeneron LC-në përkatëse dhe lajmëron aplikantin me e-mail). - Çështja i shfaqet regjistruesit të QKB-së për trajtim të mëtejshëm. Regjistruesi proceson aplikimin dhe pas aprovimit të tij, çështja i kalon ministrisë për shqyrtim. Në rast se regjistruesi nuk e aprovon aplikimin, aplikanti njoftohet me e-mail për arsyen e refuzimit. - Ministria shqyrton	E plotë	Nuk ka

				aplikimin dhe merr vendim aprovues ose refuzues për çështjen. Në rast refuzimi, aplikanti njoftohet me e-mail edhe mbi arsyen. - Në rastin e aprovimit të aplikimit nga ministria, licenca përkatëse ose aktivizohet direkt prej saj kur dhënia e licencës është pa pagesë ose shfaqet në radhën e punës të sportelistit të QKB-së për ngarkimin e mandatit të pagesës. - Pas kryerjes së pagesës nga aplikanti, licenca aktivizohet nga sportelisti i QKB-së. Sportelisti vijon me gjenerimin e dokumentit të licencës, e nënshkruan atë elektronikisht dhe e dërgon në seksionin “Dokumentet e mia” te “Hapësira ime” Gjithashtu aplikanti mund të tërheqë dokumentin e licencës në sportel. Bashkëlidhur do të gjeni linkun për të kryer këtë aplikim: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9740 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
28	09.03.2023	Kërkesë për informacion për regjistrim të personit fizik	10.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Për të regjistruar biznesin tuaj si person fizik ju duhet të kryeni aplikimin "për regjistrim fillestar të personit fizik" në portalin e-albania. Hapat e procedures - Identifikohuni si shtetas shqiptar ose shtetas i huaj; - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrimin fillestar të personit fizik / Application for the initial registration of the physical person" - Klikoni butonin "Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi formën e shoqërisë të cilën do të regjistroni; - Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit; - Punonjësi i QKB-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit. Bashkëlidhur do të gjeni linkun për të kryer këtë kërkesë : https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15356 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
29	10.03.2023	Kërkesë për informacion për aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individin	10.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion lidhur me pasuritë dhe pronat e patundshme, nëna juaj duhet të bëjë një Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë pranë portalit e-albania. Hapat e procedures - Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal	E plotë	Nuk ka

				- Zgjidhni shërbimin " Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe institucionet” - Klikoni butonin "Përdor" - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi pronën, shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme - Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit - Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose krediti; - Punonjësi i ASHK-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek “Dokumentet e mia” në e-Albania. * Pas kryerjes së aplikimit ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen e aplikimit të kryer, por do të mund të merrni përgjigjen me vulë dhe firmë elektronike tek "Dokumentat e Mia" në profilin tuaj në e-Albania. Bashkëlidhur do të gjeni linkun për të kryer këtë aplikim: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
30	10.03.2023	Kërkesë për informacion për leje legailizimi	10.03.2023	Përhëndetje. Në vijim të kërkeses tuaj për informacion , ju bëjmë me dije se nuk kemi informacion për këtë zone kadastrale .Por si ZRVPP do të zgjidhni Drejtorinë e Qytetit tuaj . Për cdo pyetje paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, në mënyrë që t`Ju asistojmë për veprime të mëtejshme. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
31	10.03.2023	Kërkesë për informacion për Pajisje me certifikatë pronësie	10.03.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, fillimisht duhet të aplikoni ne linkun me poshtë; Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444 Kërkoni shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ” dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime: R6-Aplikim për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme L1- Lëshim certifikate pronësie; I5- Lëshim kopje karte te pasurisë; I4- Lëshim	E plotë	Nuk ka

				kopje te fragmentit te hartës kadastrale. Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është shkresa përcjellëse qe ju jane kerkuar keto sherbime , çdo document tjetër duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “<i>Dërgo</i>”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në postë për të kryer pagesën dhe postimin e dokumentacionit .Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.		
32	10.03.2023	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi në portalin e-albania	10.03.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
33	10.03.2023	Kërkesë për informacion për verifikim aplikimi	10.03.2023	Përhëndetje ,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje! Kemi bere nje aplikim per Shtim afati te administratorit ,aplikimi me Nr CN-086998-03-23.Është e disata herë që ne aplikojmë dhe nuk e kuptojmë që aplikimi ynë kthehet në statusin jo i plotë.Në refuzimin e aplikimit na shkruhet që në aplikim nuk janë plotësuar të dhënat: të ndryshohet vetëm afati i administratorit, gjë qe ne e kemi bërë dhe e dyta është hapur një adresë dytësore që nuk shprehet në vendim,kur ne nuk kemi adresë dytësore.. ju lutemi shikojeni dhe na ktheni një përgjigje. Duke ju uruar gjithë të mirat e pune të mbarë.Bashkëngjitur dokumentat.	E deleguar	Nuk ka

34	10.03.2023	Kërkesë për informacion për kompesim të energjisë elektrike	10.03.2023	Përshëndetje! Në momentin që jeni përfitues i kompesimit të energjisë elektrike njoftoheni me anë të llogarisë tuaj në e-albania tek hapësira Mesazhet e mija dhe tek Dokumentat e mia si dhe pagesa të kalon në marrjen e pensionit të radhës. Pra nuk ka asnjë shërbim për vërtetim të kompesimit të energjisë elektrike në e-albania. Nqs ju intereson mund ta bëni me kërkesë me shkrim pranë postës dhe ta depozitoni në DRSSh përkatëse. Ditën e mirë!	E plotë	Nuk ka
35	10.03.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë mes dy shtetasve shqiptarë	13.03.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës. - Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqiptar/e, Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shpalljen e martesës midis dy shtetasve shqiptarë në republikën e Shqipërisë është: certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; fotokopje e dokumentit të identifikimit dhe jo pasaporte ; prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; Pra, ju duhet të paraqiteni edhe në Peshkopi edhe në Tiranë në zyrat e gjendjes civile, për të realizuar shpalljen e martesës. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
36	10.03.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë me shtetas të huaj	13.03.2023	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar): Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martesë (vërtetim për leje lidhje martesë); Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; Fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni	E plotë	Nuk ka

				duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: Certifikatë lindje; Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
